



---

*Kultura në Kosovë,*  
RAPORT I DEBATIT *specia që*  
*duhet shpëtuar*

---

Dhjetor 2014, Prishtina



---

# *Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar*

**RAPORT I DEBATIT**

---

Autor: **Agron Krasniqi**



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit Europian në Kosovë



Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme Internacional Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

*“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”*

# Hyrje

Debati “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar” është mbajtur më 19 nëntor 2014, në kuadër të projektit Forumi për Zhvillim Kulturor, i cili ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2011, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikën kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë, ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest.

Diskutimi në debat u zhvillua rreth temave të prezantuara nga analiza autoriale “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar”, e autorit Florent Mehmeti, kryetar i Forumit Kulturor. Analiza nga të pranishmit u vlerësua një ekzaminim i mirë i gjendjes së kulturës në Kosovë që nga paslufta duke shpërfaqur problemet, sfidat me të cilat ballafaqohet kultura dhe mënyrën se si mund të dilet nga kjo situatë. Pjesëmarrës në debat ishin përfaqësues të organizatave kulturore që veprojnë në Kosovë, artistë të pavarur, organizatorë festivalesh, përfaqësues

nga Ministria e Kulturës, deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe gazetarë të kulturës.

Në debatin e mbajtur në Prishtinë, Forumi Kulturor publikoi analizën “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar”, i cili analizon politikën kulturore të Kosovës dhe synon që në mënyrë të përmbledhur të argumentojë nevojën për qasje strategjike ndaj zhvillimit kulturor në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë debat ishin përfaqësues të institucioneve shtetërore, partive politike, gazetarë të kulturës dhe përfaqësues të skenës së pavarur kulturore. Në pjesën e parë të debatit u prezantua analiza autoriale “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar” e Florent Mehmetit, kryetar i Forumit Kulturor. Në pjesën e dytë të debatit, u diskutua mbi të gjeturat e analizës dhe mënyrat për t’i rishikuar politikën aktuale kulturore në Kosovë.

Ky debat është pjesë e përpjekjeve të Forumit Kulturor për të strukturuar dialogun mes skenës së pavarur kulturore dhe partive politike, deputetëve, MKRS-së dhe komunave mbi agjendën shtetërore të kulturës. Tema që e dominoi debatin ishte nevoja për të krijuar matës të performansës (indikatore) në sektorin e kulturës. Pjesëmarrësit e debatit kanë

shfaqur pajtim të plotë për nevojën e zhvillimit të indikatorëve, si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe cilësisë në prodhimtarinë artistike. Një aspekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë shtetërore në kulturë u vlerësua të jetë llogaridhënia e zyrtarëve që udhëheqin me këtë sektor. Duke filluar nga ligjet e kulturës e deri tek mënyra e ndarjes buxhetore për kulturën, ekziston hapësirë e gjerë për llogaridhënie ndaj publikut për modelin kulturor që institucionet e kanë zbatuar deri tani. Partneriteti mes skenës së pavarur kulturore dhe institucioneve të shtetit u vlerësua si faktor qenësor i rishikimit të politikave kulturore dhe ndërtimit të një modeli funksional kulturor në të dyja nivelet e qeverisjes në Kosovë.

Analiza e prezantuar në debat, sipas pjesëmarrësve është një udhërrëfyes shumë i mirë për Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e tjera për hapjen e një dialogu gjithëpërfshirës për politikat kulturore që shteti duhet t'i ndjekë. Analiza “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar” i liston frenimet, mallkimet dhe shanset e humbura të kulturës në 15 vitet e fundit, si dhe ofron alternativë për vendosjen e trendit zhvillimor në kulturë. Ky trend zhvillimor, sipas analizës kërkon: matje të potencialeve dhe analizë të mundësive,

praktikim të politikave bashkëkohore, fuqizim të parimeve të meritokracisë, valorizim të prodhimtarisë kulturore, zhvillim të potencialit për kritikë, decentralizim e depolitizim të kulturës dhe qasje gjithëpërfshirëse sektorale.

Debati u mbajt në kuadër të projektit Forumi për Zhvillim Kulturor, i cili ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2011. Projekti “Forumi për Zhvillim Kulturor” është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe Olof Palme International Center, ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Analiza “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar” synon që në mënyrë të përmbledhur të argumentojë nevojën për qasje strategjike ndaj zhvillimit kulturor në Kosovë. Duke tentuar që të përmbledhë faktet, fenomenet dhe praktikat më të rëndësishme të jetës kulturore të Kosovës, sidomos të 15 vjetëve të fundit, kjo analizë synon që t'i japë dritë një procesi konkret, i cili do të vendoste trendët zhvillimorë në sektorin kulturor në Kosovë.

# Përmbledhje e diskutimeve të përgjithshme

Analiza “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar”, e prezantuar në këtë debat nga Florent Mehmeti, kryetar i Forumit Kulturor, tenton që të përmbledhë faktet, fenomenet dhe praktikatat më të rëndësishme të jetës kulturore të Kosovës, sidomos ato të 15 vjetëve të fundit. Punimi synon që t’i japë dritë një procesi konkret i cili do të vendoste trendët zhvillimorë në sektorin kulturor në Kosovë. Duke qenë pjesë e iniciativës së Forumit Kulturor, rrjetit të organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës, ky punim ka marrë për bazë të dhëna nga raporte të prodhuara nga kjo iniciativë, siç janë: “Pse na duhet një strategji e kulturës?”, përgatitur nga Forumi Kulturor, për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Hulumtimi i politikave qeverisëse në kulturë në Kosovë”, i bërë nga Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor për Forumin Kulturor si dhe raporti i hulumtimit “Politikat kulturore dhe ndarja e buxhetit për kulturën në Kosovë”, përgatitur nga Dren Pozhegu për Forumin Kulturor. Megjithatë, ky punim në masë të madhe përkon me pikëpamjet dhe konceptet e zhvilluara të autorit nga përvoja e tij 20 vjeçare në sektorin e kulturës duke analizuar trendët dhe praktikatat e jetës kulturore në Kosovë, por edhe duke u bazuar në parime e praktika nga përvoja

e tij ndërkombëtare në fushën e kulturës.

Autori, konstaton se në 15 vjetët e pasluftës në Kosovë nuk ka pasur apo ka pasur një zhvillim shumë të vobektë të sektorit kulturor. Një prej arsyeve, sipas tij, është mospërfshirja e njohësve të zhvillimeve kulturore në qeverisje, duke përfshirë këtu edhe postet ministrore, drejtoritë komunale e deri tek institucionet kulturore.

Në këtë pikë u pajtua edhe Skënder Boshtrakaj, artist dhe zyrtar i Ministrisë së Kulturës. Ai u shpreh kritik për praktikën e deritashme për personat që vijnë në krye të Ministrisë së Kulturës pa agjendë dhe të cilët nuk janë persona të cilëve ua dimë mendimet paraprakisht për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me kulturën. Boshtrakaj, gjithashtu tha se profesionistët e fushës, njerëzit e kulturës duhet të jenë më aktiv në hartimin dhe artikullimin e politikave kulturore. “Forumit Kulturor, me këto 28 produkte të cilat i ka premtuar se do t’i kryejë për një kohë të shkurtër, po e nxjerr produktin e parë të politikës kulturore në Kosovë. Pa marrë parasysh se çka do të përmbajë ky është mendimi ynë dhe nga ky do të dalë një debat se kah po shkon Kosova me politikatat kulturore. Sigurisht është vonuar për

15 vjet, ka mundur që diçka e tillë të ndodhë menjëherë pas luftës, por e mira është që po vjen prej vetë komunitetit”, potencoi Boshtrakaj.

Nga ana tjetër edhe Kamuran Goranci, Drejtor i Departamentit të Kulturës në MKRS, tha se pajtohet me shumicën e atyre konkluzave që u prezantuan në analizë. Ai fajin për këtë gjendje të kulturës ua la edhe partive politike, të cilat konkurrojnë për të ardhur në pushtet, e të cilat sipas tij “nuk kanë strategji të mirëfilltë për zhvillimin e kulturës, por në fund vendosin për një person që do të udhëheqë me atë ministri”.

Nëse kthehemi mbrapa, për ta parë se si është zhvilluar kultura në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, del se fundi i viteve të 60-ta si dhe vitet e 70-ta dhe 80-ta njihen si epokë kur pati një zhvillim më të hovshëm të gjithëmbarshtëm shoqëror, e me këtë pati edhe një zhvillim kulturor në Kosovë. Këto zhvillime mund të thuhet se vunë bazat e zhvillimeve më të hovshme kulturore në përgjithësi dhe ndikuan në zhvillimin profesional të veprimtarisë dhe prodhimtarisë artistike në Kosovë. Kjo epokë konsolidon institucionet kulturore në Kosovë dhe fillon një

periudhë e ekspozimit kulturor edhe jashtë kufijve të Kosovës.

Me okupimin edhe de jure të Kosovës dhe suspendimin e autonomisë, në vitin 1989, fillon edhe epoka tjetër, e cila, deri në çlirimin e vitit 1999, njihet si epokë e errët shoqërore e sidomos kulturore. Veprimtaria kulturore zhvillohet jashtë institucioneve kulturore dhe ato pak zhvillime kulturore fillojnë të bëhen edhe lëvizje e rezistencës ndaj regjimit të instaluar në Kosovë. Kjo periudhë karakterizohet me aktivitetet solidarizuese kulturore që mbajtën gjallë shpirtin e popullit nën okupim dhe në të njëjtën kohë lindjen e një brezi të ri artistësh, të cilët do të jenë bartës të zhvillimeve artistike të Kosovës së pasluftës. Edhe pse nën okupim, vitet e 90-ta krijojnë një lëvizje kulturore vibrante me një cilësi të mirë dhe karakterizohet me solidarizim, mbështetje dhe fuqizim të publikut, gjegjësisht popullit nën okupim.

Përderisa gjatë viteve të 90-ta arsytimi për zhvillime të vobekta në sektorin kulturor ishte okupimi, ky arsytim nuk qëndronte më pas çlirimit të vitit 1999 dhe në një klimë shumëfish më të favorshme dhe me burime e potenciale gjithnjë në rritje, Kosova dështon në



këtë 15 vjetësh të krijojë baza të forta të zhvillimit të sektorit. Fillimisht ngërçet më të mëdha u krijuan nga administrata e UNMIK-ut (Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), që qeverisi Kosovën deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 2008.

# Nevoja për buxhet më të madh për kulturën

Në këtë debat të pranishmit kërkuan që të bëhet më shumë për kulturën, të ndahet buxhet më i madh dhe të gjenden mundësi ligjore që këto mjete të sigurohen gjithsesi. Sipas hulumtimit “Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë”, të bërë nga Forumi Kulturor, del se në vitin 2011 Kosova shpenzoi vetëm 6.3 euro për kokë banori për nevojat kulturore. Kjo rezultoi si shpenzimi më i ulët në të gjithë Europën. Krahasimi i bërë me shtete të ndryshme të Evropës e vërteton këtë fakt: Moldavia (7.7 €), Gjeorgjia (9.3 €), Maqedonia (24.5 €) dhe Serbia (15 € vetëm nivel i qendror) Norvegjia (446 €), Zvicra (235 €), Azerbajxhani (39 €).

Gjejtane Hoxha, Drejtoreshë Ekzekutive e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore duke folur rreth kësaj teme tha se ka ende shumë punë për t’u bërë në mënyrë që të arrihet atje ku janë synimet e komunitetit artistik dhe shoqërisë në përgjithësi. “Duhet të lidhet politika me ekonominë në mënyrë që të ketë lehtësira fiskale. Normalisht që në këto procese mund të ketë edhe abuzime e shpëlarje parash, por duhet të ndërtohen paralelisht edhe mekanizmat për përcjelljen e gjendjes. Duhet që në Kuvendin e Kosovës të elaborohen

politikat për mbështetjen kulturore. Tash i kemi 6 euro për kokë banori, ndoshta duhet të bëhet 10 euro e duhet ku i kemi e ku s’i kemi t’i gjejmë ato. Ky vend nuk ka pasur asnjëherë më shumë nevojë për kulturë e shprehje artistike”.

Ndërsa Besa Luzha, nga Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung, tha se “Kulturën duhet të fillojmë ta shohim si sektor normal sikur të gjithë sektorët e tjerë, bile edhe si biznes, si vend pune dhe si sektor që sjell të hyra, e jo vetëm si diçka me të cilën ne mund të merremi vetëm kur kemi kohë e nuk dimë çka të bëjmë tjetër”.

I pranishëm në debat ishte edhe Mytaher Haskuka, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje në Parlamentin e Kosovës. Ai tha se “Kulturën nuk mundemi me ia lënë vetëm tregut të lirë, pasi që në një vend të vogël si Kosova me një sektor privat jo shumë të zhvilluar, i cili është i varur nga sektori publik, nuk mundemi me pas një zhvillim të mirëfilltë të kulturës. Duhet ta balancojmë tregun me subvencione, po nëse shkojmë vetëm me subvencionime të kulturës e mbysim kreativitetin, në anën tjetër nëse ia lëmë vetëm tregut të lirë, nuk do të ketë mbijetesë dhe krijuesit vetëm do të jenë specie në zhdukje”. Haskuka, shpalosi

edhe disa ide konkrete të partisë së tij, të cilat do të mundohen t'i shtyjnë përpara në Parlamentin e Kosovës. “Ne mendojmë që libri nuk duhet të ketë tatim, pasi që nuk mund të konsiderohet libri si një mall i luksit dhe e njëjta duhet të jetë me të gjitha aktivitetet kulturore. Ato nuk duhet me pas tatim ose TVSH ku shteti merr mbrapa diçka. Këto çështje do të mundohemi t'i ngrehim edhe në Parlamentin e Kosovës”, tha ai.

# Llogaridhënia për projektet e financuara

Si temë e cila zuri një vend të veçantë në debat ishte edhe diskutimi për mënyrën e financimit të institucioneve dhe aktiviteteve kulturore. Florent Mehmeti tha se “Ministria e Kulturës për krejt këto 15 vite, me përjashtime sporadike, është sjellë si Ministri e vetëm tetë institucioneve në vartësi të saj dhe për gjithë pjesën e mbetur të jetës kulturore ka konsideruar se nuk ka ndonjë obligim apo përgjegjësi për të financuar, por thjesht mundohet të ndihmojë aq sa mundet. Vënia në pozicionin e “ndihmuesit” domosdoshmërisht imponon mendësinë e shpërndarjes secilit nga pak duke u tentuar me çdo kusht një lloj barazie bazuar në masën e financimit respektivisht subvencionimit. Për më shumë, numri i projekteve të financuara gjithnjë është promovuar si indikator i suksesit pa asnjë vlerësim të cilësisë apo ndikimit të këtyre projekteve”.

Gabimi në tërë këtë, sipas të pranishmëve në debat, është se ndarja e buxhetit dhe financimi i projekteve është bërë pa një analizë paraprake si dhe pa vlerësuar fuqinë, performancën, madhësinë dhe seriozitetin që ato përfaqësojnë. Thjesht financimi i vazhdueshëm dhe në rritje i këtyre institucioneve është konsideruar si një “obligim ligjor”.

“Kjo ka krijuar pasoja të pariparueshme duke i mundësuar institucioneve të dobëta që të shfrytëzojnë këto mjete sikur t’i kishte sjellë Babadimri, si një dhuratë e mirëseardhur, përderisa institucionet e tjera me potencë shumë më të madhe kanë stagnuar dhe kanë prodhuar demoralizim e depresion brenda institucioneve të tyre dhe rrjedhimisht edhe përballë publikut të tyre ku ata operojnë”.

Duke folur rreth kësaj çështjeje, deputeti Haskuka tha se duhet të ketë llogaridhënie, dhe kjo duhet të bëhet me matje, pasi që nuk bën që një aktivitet kulturor të marrë shumë fonde e të mos ketë kthime mbrapa. “Kultura duhet edhe të gjenerojë mjete, p.sh. nëse i merr 10 mijë euro fonde duhet të gjenerojë 20 ose 30% mjete të hyra vetanake, nga shitja e atij malli në treg. Ka sigurisht edhe krijimtari artistike vlera e të cilës kuptohet shumë më vonë, por ideja është që krijohet njëfarë procesi që kultura të subvencionohet, por të ketë kritere që sa më shumë njerëz të përfitojnë nga ajo”.

Zonja Gjejlane Hoxha, ndërkaq tha se ende nuk e kupton pse nuk e kemi një Këshill Nacional për Kulturën, e i kemi shumë këshille të tjera.

# Indikatorët, përcaktues të domosdoshëm për (mos) suksesin e një projekti

E rëndësishme është që projektet e financuara të përcillen për mënyrën e realizimit, për të parë nëse i arrijnë synimet e premtuara, u tha nga panelistët. E kjo duhet të bëhet me matje dhe bazuar në meritokraci. Janë indikatorët që duhet të përcaktojnë nëse projekti në fjalë ia ka vlejtur ose jo dhe pikërisht në bazë të atyre indikatorëve mund të vendoset për vazhdimin e financimit dhe rrugën që duhet ta ndjekë ai projekt në të ardhmen. “Nuk duhet me pas projekt pa kriteret dhe pa indikatorë. Duhet të merremi vesh për këta indikatorë, fillimisht se cili është synimi i atij projekti, qoftë për të hyrat e projektit, pjesëmarrjen, përfshirjen, promovimin, a duam ta stimulojmë inovacionin ose diçka të tillë”, tha Skënder Boshtrakaj.

“Të hyrat vetanake të institucioneve kulturore janë treguesi kryesor i suksesit dhe matja më e mirë e punës së menaxhmentit të një institucioni publik kulturor. Ky matës është indikator kyç në vlerësimin e performancës së institucioneve kulturore në trendët bashkëkohorë të politikave kulturore. Ky matës nuk është përdorur asnjëherë në Kosovë për të rishikuar punën e menaxhmentit dhe situata e tillë ka prodhuar edhe anomali që për botën e zhvilluar kulturore jo që janë skandaloze, por edhe komplet të pakuptimta: siç janë

rastet kur gjatë gjithë vitit kalendarik 2006 Teatri Kombëtar kishte gjeneruar gjithsej 600 euro të hyra vetanake, apo edhe rasti kur shitja e biletës së parë nga Filarmonia e Kosovës pas më shumë se një dekade të funksionimit bëhet lajm për media”, thuhet në analizë.

Hajrulla Çeku, nga organizata “EC Ma Ndryshe”, u ndal te parimi i kthimit të tatimit që e paguajnë qytetarët. “Po flasim për pjesën e fondeve publike, aty ku ne e japim taksën tonë, e cila duhet të jetë e kthyeshme dhe pyetja është sa po më kthehet mua ai tatim, dhe në bazë të cilave kriteret po vlerësohet financimi i një projekti të caktuar”.

Edhe Besa Luzha, e ndau mendimin se mungojnë hulumtimet sektoriale për të cilat mund ta dimë se ku qëndrojmë. Ajo tha se duhet t’i kushtohet më tepër vëmendje një X shfaqje ose festivali që ka më tepër publik. Por, sipas saj, secili sektor duhet t’i zhvillojë indikatorët e vet, ndryshe duhet të jenë për muzikën, për teatrin, ekspozitat, ndryshe për librat, etj.

Një e metë tjetër që u potencua nga panelistët, është mungesa e kritikës profesionale që do të mund të ishte një filtër dhe një orientim i mirë për vlerësimin e festivaleve dhe ngjarjeve të caktuara kulturore.

# Rekomandime

**Raporti “Kultura në Kosovë, specia që duhet shpëtuar”, ka ofruar një numër veprimesh që duhen ndërmarrë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm kulturor hapat e rëndësishëm:**

- heqja e pengesave së pari brenda nesh dhe më pastaj edhe në legjislacion dhe akte normative për të mundësuar eliminimin e stereotipave të krijuara me vite të quajtura në këtë punim si “frenime” dhe “mallkime”,

- analizimi i shanseve të humbura në të kaluarën, për të mos përsëritur gabimet strategjike që janë bërë për kohë të gjatë,

- vendosja e mendësisë së matjes duke identifikuar kështu qartazi potencialet dhe mundësitë për zhvillim,

- futja në praktikë të politikave kulturore që sigurojnë investime në edukim e kërkim për të krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillim kulturor,

- fuqizimi i parimeve të meritokracisë, duke siguruar që çdo investim publik të zë vend të duhur duke maksimalizuar rezultatin proporcionalisht me investimin,

- decentralizimi dhe depolitizimi i jetës kulturore në Kosovë për të siguruar kështu një jetë kulturore që zhvillohet krahas nevojave shoqërore e pakufizuar nga burokracia shtetërore

dhe shumë më llogaridhënëse ndaj publikut të cilit i shërben,

- krijimi i sinergjive për vendosjen e kulturës në politikëbërjen e shumë instancave në vend,

- sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës si garantë e trasimit të rrugës së zhvillimit kulturor në Kosovë.

**Ndërsa, debati përfundoi më këtë listë rekomandimesh:**

- Përfshirja e njohësve të zhvillimeve kulturore në qeverisje, duke përfshirë këtu edhe postet ministrore, drejtoritë komunale e deri tek institucionet kulturore,

- Strategji më të qarta dhe konkrete të partive politike për kulturën, të vendosura në formë të shkruar në programet e tyre politike,

- Rritje e buxhetit shtetëror për kulturën duke reflektuar në rritjen e përgjithshme të buxhetit dhe nevojat e institucioneve të kulturës,

- Financimi i projekteve në bazë të kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe në bazë të indikatorëve matës,

- Përcjellja dhe vlerësimi i projekteve të financuara nga buxheti shtetëror për t'u siguruar që po i arrijnë objektivat e prezantuara,

- Stimulimi i gjenerimit të të hyrave

vefanake nga projektet kulturore për të luftuar varësinë nga burimet e caktuara financiare,  
- Krijimi i Këshillit Nacional për Kulturën si trup qendror koordinues për të avancuar agjendën kulturore të Kosovës.

# Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si Sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

## **Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:**

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,
- Afirmimit të organizatave anëtare,

- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

## **Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:**

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës
- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave
- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit
- Trajnimet specifike për nevojat e organizatave anëtare
- Organizimi i debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore



# Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikave kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrejtin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë



Implementuar nga:





KULTURA NË KOSOVË, SPECIA QË DUHE

*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*

